

A K T -T H E M E L I M I

I SHPK "O S M A N I"

Në qytetin e Gramshit, sot më datën Nr. 12~ 1996, unë, Mustafa Osman, i biri i Gurit dhe i Tanës, i datëlindjes 1963, me banim në qytetin Gramshit, me arsim të lartë për mësuesi në lëndët biologji-kimi, nji mbështetje të ligjës Nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", si dhe në shëtitat e mëvonëshme në ligjet Nr.7608 dhe 7667 të vitit 1993, meqënëse plotësoj të gjitha kushtet, hartoja këtë akt-themeli për krijimin e shoqërisë private me aftësi të kufizuar(shpk) dhe më akti vitet sipas objektit të saj, si më poshtë:

N e n i 1

Të krijoj shoqërinë private me përgjegjësi të kufizuar (shpk), të emërtuar "OSMANI".

N e n i 2

Shpk "Osmani" e ka selinë e saj në qytetin e Gramshit, paisur me numër telefoni _____.

Ajo ka vulën e saj të veçantë.

N e n i 3

Shpk "Osmani" krijuhet për të ushtruar një aktivitet me kohë-zgjatje mbi 15 vjet dhe ky afat mund të zgjatet në vartësi të kushteve dhe leverdishmërisë ekonomiko-financiare të saj.

N e n i 4

Shpk "Osmani" do të ketë si objekt dhe aktivitete kryesore:

-Veprimtarinë tregtare të shitblerjes, me shumicë dhe me pakicë të mallrave ushqimore dhe industriale, të siguruara brenda e jashtë rrëthit, si dhe me jashtë shtetit.

-Blerje dhe shitje me shumicë e me pakicë të pjesëve të këmbimit për automjete të të gjitha llojeve, të siguruara brenda e jashtë vendit.

-Veprimtari në fushën e ndërtimit të banesave, shkollave, kopshteve, rrugëve të komunikacionit e të tjera.

-Blerje dhe shitje të materialeve të ndërtimit dhe trasportimin e tyre.

-Blerje dhe shitje të karburanteve me pikë furnizimi me mësime.

-Shfrytëzim të lëndës drusore, blerjen, përpunimin dhe shitjen e saj.

-Ushtrimin e veprimtarisë së rritjes, zënies dhe shitjes së peshkut në rezervuarin e Banjës dhe rezervuarë të tjerë brenda rrëthit Gramsh.



-Veprimtari të tjera të lindjeshme që do të sjellin lejerdi ekonomike për shpk "OSMANI".

N e n i 5

Shpk "OSMANI" e fillon veprimtarinë e saj me një kapital fillest prej 1000000 lekë(një milion lekë). Gjithashtu kjo shoqëri ka të depozituar shumën prej 100 mijë lekë pranë Bankës Tregtare Gramsh.

N e n i 6

Shpk "OSMANI" drejtohet nga administratori i saj Zoti Mustafa Osmani dhe me zgjerimin e aktivitetit të saj nga mbledhja dhe organet e saj.

N e n i 7

Shpk "OSMANI" ka të drejtë të pranojë si anëtarë të tjerë edhe persona ortakë ose me kontratë të vëçantë.

N e n i 8

Viti finanziar i shpk "OSMANI" fillon më 1 janar dhe mbeten më 31 dhjetor të çdo viti.

N e n i 9

Shpk "OSMANI" mund të shpërbëhet në ato raste që citojen shprehimisht në statutin e saj si dhe me akte ligjore e nënligjore të organeve kopetente.

N e n i 10

Shpk "OSMANI" në të gjithë veprimtarinë e saj do të zbatojë aktet ligjore dhe do të përgjigjet para organeve gjyqësore dhe administrative për shkeljet e ndryshme.

N e n i 11

Shpk "OSMANI" do të krojoi të gjitha lehtësirat për të ushtruar kontroll nga organet kopetente mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të saj.

A D M I N I S T R A T O R I

/ MUSTAFA GURI OSMANI /


Nr. 11261 Rep.

Nr. 1839 Kol.

V E R T E T I M

Sot me date 12-12-1966 (nentdhjete e gjashte) u paraqit para meje noterës së ketij qyteti Fatmira Ilie Zoti Mustafa Osmani i biri i Gurit i dat. 1963 lindur dh. banues ne Gramsh madhore me zotesi të plote juridike per te vepruar për identitetin e tij cilët u sigurova me dokumentin perkates i cili me vullnetin e tij te lire dhe te plote deklaroi permbejtjen e kesaj akti themeltar duke e nenschruar rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjes.

Talise
Mlli
59 dec


NOTERIE

Fatmira Ilie

S T A T U T

I

SHPK "OSMANI" G R A M SH

Në qytetin e Gramshit, sot më datën 12.11.1996, Unë, Mustafa Guri Osmani, administrator i shpk "OSMANI", në mbështetje të aktit të themelimit për të ushtruar veprimtarinë në mënyrë të ligjë shme të kësaj shoqërie, hartoj statutin e mëposhtëm:

F O R M A - E M R I

N e n i 1

Shoqëria që kam themeluar është me përgjegjësi të kufizuar (shpk), të cilën e kam emërtuar "OSMANI".

S E L I A E S H O Q È R I S È

N e n i 2

Shpk "OSMANI" e ka selinë e saj në qytetin e Gramshit. Ajo vulën e saj të veçantë dhe është e lishur me telefon me Nr.

K O H È Z G J A T J A

N e n i 3

Shpk "OSMANI" krijohet për të kryer një aktivitet mbi 15 vjet, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në gjykatën e rrëthit Tiranës.

Ky afat mund të zgjatet me pëlqimin e ortakëve, por edhe mund shkurtohet në rast se shoqëria do të shpërbëhet para se të mbarojë afati i mësipërm.

O B J E K T I I V E P R I M T A R I S È S È S H P K " O S M A N I "

N e n i 4

Shpk "OSMANI" ka si objekt të veprimtarisë së saj:

-Veprimtari tregtare të shitblerjes me shumicë dñe me pakicë të mallrave ushqimore dhe industriale, të siguruara brenda dhe jashtë rrëthit si dhe me jashtë shtetit.

-Blerje dhe shitje me shumicë dñe me pakicë të pjesëve i këmbimit për automjete të të gjitha llojeve, të siguruara brenda dëjashtë vendit.

-Veprimtari në fushën e ndërtimit të banesave, shkollave, kopshteve, rrugëve të kominkacionit e të tjera.

-Blerje, transport dhe shitje të materilave të ndërtimit

-Blerje dhe shitje të karburanteve me pikë furnizimi di me mjete.

-Shfrytëzim të lëndës drysore, blerjen, përpunimin dhe shitjen e saj.

-Ushtrimin e veprimtarisë së rritjes, zenies dhe shitje

peshkut në rezervuarin e Banjës dhe rezervuarë të tjera brenda rrëthit Gramsh.

-Si dhe veprimtari të tjera të ligjëshme që do të sjellin leverdi ekonomike për shpk "OSMANI".

K A P I T A L I T H E M E L T A R
N e n i 5

Kapitali thmelistar fillestar i shpk "OSMANI" është 1 milion lekë si dhe 100 mijë lekë të depozituara pranë Bankës Tregtare Gramsh.

Kapitali fillestar i shpk "OSMANI" është tërësisht i shlyeshëm dhe i dokumentuar.

N e n i 6

Kapitali i shpk "OSMANI" është lirisht i transferushëm në rrugë trashëgimie, pjesëtimi të saj si dhe për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve.

N e n i 7

Përfitimet nga veprimtaria e shpk "OSMANI" i përkasin administratorit themelues të saj, zotit Mustafa Osmani.

Me zgjerimin e saj me ortakë të tjerë, fitimet do të ndahen në bazë të kontributit të sejcilit me kapitalin e derdhur.

O R G A N E T D R E J T U E S E

N e n i 8

Shpk "OSMANI" drejtobet nga administratori i saj, zoti Mustafa Osmani. Me zgjerimin e aktivitetit të saj me ortakë të riut shpk do të ketë së organ drejtues edhe mbledhjen e ortakëve.

N e n i 9

Administratori i shpk "OSMANI" përfaqëson shoqërinë në të gjithë veprimtarinë e saj adminstrativo-ekonomike dhe juridike.

Me autorizim me shkrim të tij, shoqërinë mund ta përfaqësojë çdo person tjetër nga ortakët ose specialist, duke patur akt-përfaqësimi të veçantë.

N e n i 10

Administratori ose mbledhja e ortakëve e shpk "OSMANI" miratohet:

-Bilancin ekonomik vjetor.

-Masën e shtesës së fondit themeltar dhe të fondeve të veçanta.

-Përdorimin dhe shpërndarjen e fitimit.

-Cakton ekspertët kontabël dhe të fushave të ndryshme.

-Vendos për pranimin në këtë shoqëri të personave të tij si të punësuar apo si ortakë.

-Vendos kalimin e shoqërisë në procesin e likuidimit ose falimentimit të saj.

Miraton pranimin e trashpkimtarëve ligjorë me cilësinë e ortë ose të punësuarve.

D R E J T I M I I S H P K " O S M A N I "

N e n i 11

Aktiviteti i shpk "OSMANI" do të drejtohet nga administratori i saj.

Problemet financiare do të ndiqen nga një financier, ndërsa problemet e tjera do të ndiqen nga specialistë të fyshave të ndryshme duke zbatuar të gjitha rregullat dhe procedurën përkatëse.

N e n i 12

Shpk "OSMANI" e fiton zotësinë e saj për të vepruar sipas këtij statuti nga vëstori i regjistrimit në regjistrin tregtar pranë mykjes së rrethit Tiranë dhe pasi të jetë pajisur me të gjitha dokumentet tjera të nevojshme.

N e n i 13

Veprimtaria e shpk "OSMANI" do të konsiderohet e liggjshme kur veprimet juridiko-civile do të kryhen konform dispozitave me këtë statut dhe kurdoherë në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi

N e n i 14

Veprimtaria ekonomike dhe afariste e shpk "OSMANI" do të pasqyrhet realisht sipas kërkesave ligjore të sistemit finanziar dhe fiskal duke e kontrolluar këtë rezultat në afat tre mujor dhe vjetor.

N e n i 15

Pasuria dhe mjetet e investuara për themelimin e shpk "OSMANI" si dhe ato që do të shtohen nga aktiviteti i saj do të pasqyrohen e regjistrohen sistematikisht dhe menjëherë në librin dhe pasqyrat përkatëse.

S H L Y E R J A E D E T Y R I M E V E

N e n i 16

Shpk "OSMANI" do të përgjigjet me kapitalin dhe pasurinë disponuese të saj për të gjitha detyrimet fiskale dhe ndaj të tretëve të lindura pas konstituimit të kësaj shqërie.

PUNËSIMI NË SHOQERINË "OSMANI"

N e n i 17

Për realizimin e aktivitetit të saj në zonat e zhjjerim shpk "OSMANI" mund të punësojë punonjës të specialiteteve të ndryshme me kontratë vjetore ose provizore sipas ligjit" Për marrëdhëni të përsi dhe bën sigurmin e tyre në institucionin e sigurimeve shqiptarë dhe atij mbi sindikatat.

N e n i 18

I punësuari nuk merr pjesë nga fitimet e shpk "OSMANI" dhe nuk përgjigjet për humbjet e saj.

Ai përgjigjet materialisht vëç rasteve madhore për dëmin që i shkakton shoqërisë gjatë kryerjes së detyrave që i janë ngarkuar dhe besuar.

E K S P E R T È T K O N T A B È L

N e n i 19

Në raste të veçanta kur e kërkon ligji ose urdhërohet nga organet tatumore e gjyqësore, me vendim të administratorit ose mbledhjes së ortakëve ngarkohen ekspertë kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomiko-financiar.

Akti i ekspertimit sipas rastit shtrohet për diskutim në mbledhjen e ortakëve.

VITI FINANCIAR - B I L A N C I

N e n i 20

Çdo vit finanziar fillon më 1 janar dhe mbaron në 31 dhjetor të çdo viti.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe analizat mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori, llogaritja apo ekspertimet shqyrtohen dhe miratohen brenda 3 muajorit të parë të vitit pasardhës.

D I V I D E N T È T

N e n i 21

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, administratori dhe ortakët përcaktojnë pjesën që ju takon në formën e dividentëve mbi fitimin.

N e n i 22

Fitimi që ju takon ortakëve nuk mund të disponohet materialisht prej tij pa u shlyer më parë detyrimet pasurore personale sipas dokumentacionit finanziar të saj.

SHPËRBERJA E SHOQËRISË "O S M A N I"

Neni 23

Shpk "OSMANI" mund të shpërbihet:

-Me vendim të mbledhjes së ortakëve, kur për dy vjet radha nuk del rentabël.

-Në rast të falimentimit ekonomik.

-Në rastet kur shprehimisht do të citohet apo urdhërohet nga organet kopetente dhe legjislacioni në fuqi.

N e n i 24

Shpk "OSMANI" nuk shpërbihet kur njeri prej ortakëve të saj vde bëhet i paaftë ose i hiqet e drejta nga organet tatuuese për të ushtruar veprimtarinë në këtë shoqëri.

LIKUIDIMI I SHOQËRISË

N e n i 25

Shoqëria "OSMANI" do të hyjë në procesin e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj.

Në këtë rast pas shlyerjes së detyrimeve tatuuese fiskale dhe ato ndaj të tretëve, administratori ndan kapitalet e ngelura ndërmjet ortakëve në procesin dhe pjesët që ata zotërojnë në kapitalin fillestar themelor.

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

N e n i 26

Mosmarrëveshjet juridiko-civile të lindura gjatë aktivitetit të shpk "OSMANI" midis personave që janë ose jo pjesëmarrës në të ose me të tretët, kur nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen nga gjykata sipas rregullave proceduriale.

N e n i 27

Ky statut u përpilua në katër kopje për t'i përcjellë organet tatuuese dhe njera ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Gramsh, më 12.12.1996

A D M I N I S T R A T O R I

/ MUSTAFA GURI OSMANI /

QFF *GG*

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

Nr. 11265 Rep.

Nr. 1830 Kol.

V E R T E T I M

Sot me date 12.12.1996 (nentdhjete e gjashtë) u paraqit para maje noterës se ketij qyteti Faktura TIRANË Zoti Mustafa Osmani i biri i Gurit i dat 1963 lindur dhe banues në Gramsh madhore me zotesi të plote juridike për të vepruar i cili me vuillnet e tiq te lire dhe te plote me deklaroi permbytjen e ketij Statuti, për identitetin e të cilit u sigurova me dokumentin perkates, duke e nenshkruar rregullisht para maje dne u ne noterja e vertetoj atë sipas ligjes.

*fa kura e
noterit e
TIRANE
u përgjigjet*

*fa kura e
noterit e
TIRANE*